

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 29.06.2023

Kryesuesi i mbledhjes është Zv/Kryetari i Këshillit Bashkiak Edlira Mitre

Ora e hapjes së mbledhjes: 10:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 30

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej këshilltarësh: 30

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë:

Të pranishëm në mbledhje qytetarë:

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Në lidhje me rendin e ditës ka diçka? Ka ndonjë shtesë propozim apo ndryshim?

Këshilltar P.Tollkuçi: Unë propozoj një ndryshim në rendin e ditës duke qënë se në takimi apo konstituimi i KB dy këshilltarë nuk ishin të pranishëm dhe sot janë unë propozoj që pikën e parë të rendit të ditës është që këta këshilltarë të verifikohen nga komisioni i mandateve dhe të bëjnë betimin, pikën e dytë të vazhdojmë me dhënien e ndihmës ekonomike për muajin maj 2023 dhe pika 3 është për ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme në KB. Ne bëmë dhe një bisedë paraprake me kryetarin e grupit të opozitës me Devin dhe ramë dakord me këtë pjesë dhe në fund fare mbasi të miratojmë 2 pikat e para në kërkojmë pak kohë të tërhiqemi dhe të dyja grupet të vendosim emrat për komisionet e këshillit bashkiak.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Diçka tjetër për të shtuar?

Këshilltar E.Bregu: Do të doja të shtoja në rendin e ditës një debat me Universitetin e Korçës për çështjen e transferimit dhe këshilli i Korçës dha një deklaratë gjithashtu dhe një debat në lidhje me transferimin e dokumentacionit të hipotekës kadastrës në Tiranë dhe për këtë do të doja të kishte një diskutim dhe KB të dilte me një deklaratë.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Faleminderit kjo mund të konsiderohet tek pika të ndryshme në fund të rendit të ditës.

Këshilltar E.Nexhipi: Meqënëse dhe unë kam lidhje direkte me universitetin do i këshilloja të ngrenë debatin brënda institucionit, të mbarojë brënda institucionit pastaj të vijë këtu. Sepse duke diskutuar për univeristetin, duke u përpjekur ta ndihmojmë çështjen mund ta dëmtojmë. Meqënëse universiteti është një institucion autonom, të shterin njëhër diskutimet brënda institucionit pastaj të kenë mundësi të dalin jashtë. Nuk ka mbaruar akoma debati brënda, madje nuk ka filluar ende, është vetëm njëra palë që ka shprehur një mendim, pastaj të bëhet pjesë e debatit publik. Për mua dhe ata që e kanë përhapur nëpër media e kanë gabim.

Këshilltare A.Zheku: Si pjesë e univeristetit edhe unë do them 2 fjalë. Është një nga pikat më të nxehta ku ne jemi prekur, është një çështje tej mase delikate. E quaj një hap të nxituar

të diskutohet në këtë mbledhje dhe ngjyrimi politik që do ti jepet qoftë i njëjës palë qoftë i palës tjetër. Dhe pala që është më skeptike për të folur jam unë si anëtare e KB. Siç e tha Erjoni është njëçështje tej mase delikate që po diskutohet ende në instanca dhe në strukturat tona, kështu që mendoj vërtet do të jetë e nxituar të diskutohet këtu sot, aq më tepër të dalim me deklarata. Janë organet kompetente janë personat kompetent, është një çështje me interes public, prind student gjithë qarku, janë njerëz shumë të shqetësuar për këtë debat. Le ti hedhim hapat një nga një, le të mbërijnë në një fazë të dytë në KB.

Këshilltar E.Nexhipi: Madje kjo çështje për mua mendoj do një seancë të posatshme, jo thjesht ta diskutojmë në pika të ndryshme, por është shpejt të bëhet pjesë e këtij debati pa kuptuar se çfarë po ndodh, se akoma spo e kuptojmë ne që jemi pjesë e institucionit.

Këshilltare A.Zheku : Jemi të papërgatitur për këtë pikë. Dhe unë vetë isha e papërgatitur për këtë sugjerim që dha Elvini, pavarësisht se e mbështes në parim, është një çështje me rëndësi tej mase të vecantë, prandaj të jemi të përgatitur mos futet tek të ndryshme.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Unë besoj se jemi të gjithë dakord që të mos flasim paraprakisht pa u kristalizuar gjërat. Nuk kemi ne tagrin për të folur para pedagogëve para instancave.

Këshilltar E.Bregu: Këto diskutime mund ti bënim tek pika të ndryshme se po i bëjmë këto diskutime tani, dhe në ato diskutim që mund të bënim mund të vendosim që nuk do ta trajtojmë këtë herë.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Kalojmë në miratimin e rendit të ditës me ndryshimet e propozuara.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 30

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Kalojmë tek **pika e 1 e rendit të ditës**. Verifikimi i mandateve të dy këshilltarëve që sot janë prezent Erjols Haxhillari dhe Irvin Bode. Komisioni i mandateve.

Sekretare E.Naçi: Të paktën duhet të kemi 2 anëtarë të komisionit.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Nuk mund të bëjmë dot verifikimin vetëm me një anëtar të komisionit.

Sekretare E.Naçi: Komisioni është ligjor dhe është i përhershëm.

Këshilltar E.Nexhipi: Mund të bëjmë tani pushimin sa të zgjedhim emrat e anëtarëve të komisionit.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Po paraprakisht unë duhet t'ju jap komisionet si është bërë ndarja nga kryetarët e grupeve, që juve të dini. Bëjmë pushim 15 minuta për emrat e grupeve.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Sipas rendit të ditës të cilin e miratuar pak më parë do të mbledhet komisioni i mandateve për të verifikuar dy mandate të cilat do të betohen sot.

Komisioni zhvillon procedurën e verifikimit të mandateve për dy këshilltarët.

Komisioni i mandateve pasi shqyrtoi dhe 2 emrat e këshilltarëve të cilët nuk ishin mbledhjen e kaluar, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dy këshilltarëve vërteton mandatin e Erjols Haxhillari dhe Irvin Bode.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Ftoj tëdy këshilltarët të vijnë pranë mejë të lexojnë formulën e betimit.Akti i betimit: Beto hem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do ti bindem kushtetutës dhe ligjeve. Beto hem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interes e shtetasve të bashkisë Korçë dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirqënies së tyre. Beto hem!

-Tëdy këshilltarët kryejnë aktin e betimit.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 2 e rendit të ditës

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIU DHËN 1 – 31 MAJ 2023.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Relacionin e ka Petrika.

Këshilltar P.Tollkuçi: Jo relacionin e ka ekzekutivi por unë përpara takimit sigurisht që kam diskutuar me ekzekutivin në lidhje me relacionin e përgatitur nga ana e tyre. Bëhet fjalë për dhënie e ndihmës ekonomike nga 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike dhe nga fondi I buxhetit vendor për periudhën 1-31 maj 2023. Për muajin Maj, janë 61 familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar, fondi 6% i bllok ndihmës ekonomike është një fond i cili i shtohet çeljes faktike nga lista e përfituesve të ndihmës ekonomike, të përzgjedhur nga sistemi i pikëzimit. Këto familje, përzgjidhen nga ana e Administratorit Shoqëror sipas Njësave Administrative, nga familjet e pakualifikuara nga sistemi i pikëzimit me cilësimin, “Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme”.Përzgjedhja bëhet duke u bazuar kriterëve të miratuara me VKB, nëpërmjet vizitatave në familje në terren dhe duke verifikuar gjendjen social-ekonomike të familjeve aplikante, sipas ligjit nr.57/2019 “ Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave, të V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës, të neneve 12, pikat 1,4,5,16, pika 2 dhe 21 të ligjit nr.57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” të Udhëzimeve nr. 3,4, 5, pika 2, datë

17.02.2017 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Vendimit nr. 6 dhe 7 , datë 25.01.2023, të Këshillit Bashkiak Korçë “Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”, dhe nga fondi i buxhetit vendor i Bashkisë Korçë. Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi, për mos marrjen e pikëve të mjaftueshme, përfitojnë familjet me nivel më të ulët ekonomik , me probleme sociale dhe shëndetësore, personat mbi moshë pune, personat e vetmuar, familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë, familjet romë dhe egjiptiane, sipas kriterëve të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me vendim nr. 5 për kriteret e buxhetit vendor dhe vendim nr.4 për kriteret e 6%, datë 27.01.2022 Për të gjitha këto arsye, Administratorët e sektorit të pagesave, i propozojnë Këshillit të Bashkisë që gjatë muajit Maj:

1- Për muajin Maj 2023, është në dispozicioni fondit prej 277.940 lekë si 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike , nga sistemi i pikëzimit.

2- Nga ky fond, përfitojnë 61 familje, të përzgjedhura sipas kriterëve specifikë të miratuara, në shumën 200.129 lekë.

3- Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 27 familje, në shumën 33.480 lekë.

4- Pagesa totalë nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është 233.609 lekë.

5- Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor , sipas kriterëve specifikë të miratuara 18 familje, me fond prej 72.827 lekë.

Bazuar në Vendimet e mësipërme, përfituesit e kësaj kategorie, përzgjidhen kryesisht nga familjet e evidentuara nga administratorët socialë në nevojë ekstreme ekonomike dhe në kushte specifikë sociale, pavarësisht cilësimit të sistemit elektronik të përzgjedhjes.

Persona të vetmuar 10

Persona në pamundësi fizike për të punuar 3

Kryefamiljare femra me fëmijë të mitur në ngarkim 3

Familje të komunitetit rom-egjiptian, me probleme dokumentacioni 2

Ky fond është parashikuar si 6 % nga fondi i kushtëzuar, për bllok ndihmën ekonomike dhe nga fondii buxhetit vendor, i miratuar me VKB nr.6 dhe 7 , datë 25.01.2023. Në emër të grupit socialist jemi dakord për miratimin e këtij relacioni për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin maj 2023. Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Nga ekzekutivi kemi diçka? Nga këshilltarët?

Këshilltar D.Osmani: Edhe grupi jonë është dakord për dhënien e kësaj ndihme ekonomike. Do të kërkoja nga drejtorja përkatëse e Kujdesit Social që këto familje dhe familje të tjera që ne besojmë dhe kanë nevojë për mbështetjen dhe suportin e bashkisë por dhe të gjithë si qytetarë të këtij qyteti që të shikojmë me kujdes dhe prioritet dhe të mos ketë ndarje politike ekonomike fetare. E kërkojmë këtë si qytetarë dhe si këshilltarë.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Ka diçka tjetër?

Këshilltar E.Bregu: Kam parë tek ajo lista disa shifra që janë qesharake le të themi 210 lekë etj, ndaj në rastin konkret duke qënë se nuk kemi cfarë ndryshimi të bëjmë besoj se ne do ta miratojmë por në vazhdim mendoj që duhen parë me imtësi kritaret dhe KB duhet të vendosë një minimum për mbështetjen e familjes sepse nuk mund të quhet mbështetje duke dhënë 210 lek, nëse kjo konsiderohet qokëeshtë gjë tjetër, po për standartet ku jetojmë kjo nuk është serioze ndaj do ti lutesha drejtorisë përkatëse ta kenë në konsideratë përlllogaritjen dhe gjithashtu nëse është e nevojshme të mblidhemi dhe të diskutojmë në lidhje me këto kritere për të vendosur një minimum.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Një përgjigje mund ta marrim nga ekzekutivi.

Ekzekutivi A.Vranishti: Nuk janë kriteret që vendosin pagesat, kriteret janë për familjet që përzgjidhen, pagesat vendoset nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është e përcaktuar pagesa është një formulë e cila përcakton pagesën për familjen. Janë të përcaktuara në sistemin e pikëzimit për familjet përfituese për ndihmën ekonomike.

Këshilltar i opozitës : Ndihma ekonomike në gjithë shqipërinë është njësoj po thua?

Ekzekutivi A.Vranishti: Po pagesa është njësoj. Këto familje që miraton KB janë familje të cilat nuk kualifikohen në sistemin e pikëzimit kombëtar. Është një sistem pikëzimi këto familje që I kualifikojmë ne janë familje të cilat tek ky sistem kanë cilësimin nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme dhe në bazë të kërkesës që bën kjo familje administrator shoqëror bën një relacion social ekonomik, vlerësim për këtë familje, vlerësohet edhe nga përgjegjësi i drejtorisë së pagesave ky relacion dhe më pas shikohet edhe vizita në familje dhe në terren, të ardhurat e kësaj familje të gjitha kushtet socio-ekonomike dhe vendoset për tu trajtuar këtu ose jo. Është edhe një listë me kritere që miratoj cdo fillim viti nga KB me kriteret për familjet që duhet të plotësojnë për trajtimin nga fondi 6% I bllok ndihmës ekonomike dhe nga buxheti vendor I bashkisë.

Këshilltar L.Petri : Ke ndonjë të dhënë nga sa aplikime janë bërë, sa janë aprovuar dhe sa janë refuzuar? Janë aprovuar të gjithë?

Ekzekutivi A.Vranishti: Për sistemin e pikëzimit familjet paraqiten, çdo familje ka të drejtë të bëjë aplikimin për ndihmë ekonomike.

Këshilltar L.Petri : E kuptoj sa kanë aplikuar dhe sa janë pranuar?

Ekzekutivi A.Vranishti: Të gjithë që bëjnë kërkesë në bazë të kritereve kualifikohen.

Këshilltar L.Petri : Domethënë 61 kanë bërë kërkesë dhe 61 janë pranuar.

Këshilltar E.Nexhipi: Kjo është një praktikë që është ndjekur në të gjitha mbledhjet, nuk është se kjo shifra e atyre personave që përfitojnë, kjo është pjesa e atyre familjeve që nuk përfitojnë ndihmë ekonomike dhe trajtohen me këtë fondin e veçantë që është 3% apo 6% nga fondi i kushtëzuar. Pjesa që përfiton ndihmë ekonomike trajtohet nga shërbimi social shtetëror.

Këshilltar L.Petri: Meqënëse kjo shumëështë pak atëhere ne si këshill kemi të drejtë që ti bëjmë një kërkesë dhe një letër zyrtare Ministrisë në formën komunikative shkresore institucionale për tu konsideruar, pastaj sa do pijë ujë kërkesa jonëështë tjetër gjë, por në momentin që ne nuk jemi dakord ne duhet ta mbajmë qëndrimin tonë.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Duhet të jeni të sigurt që edhe për këtë pjesëështë folur dhe është shkruar dhe ne kemi reaguar herë pas here por është ligjore dhe nuk e ndryshojmë dot.

Këshilltar P.Tollkuci: Pjesa më e madhe e këshillit mendoj qëështë e re këtu përfshij dhe veten time dhe nuk është se kam ndonjë eksperiencë të madhe si këshilltar por gjithësesi kjo ishte mbledhja e parë mbas konstituimi dhe mendoj që ne duhet të kishim bërë një konsultim paraprak, pra komisionet nuk janë ngritur por do të ngrihen sot, por besoj që nga mbledhja e ardhshme dhe më tutje komisionet do të thërresin ekzekutivin dhe administratën në lidhje me gjithë dokumentat apo relacionet e përgatitura nga ata për tu miratuar nga ana jonë dhe nga mbledhjet paraprake që do të bëjmë përpara mbledhjes së këshillit mendoj që do kemi gjithë kohën e mjaftueshme që edhe të sqarohemi me relacionet e përgatitura që mos e kthejmë sallën e këshillit në vënd pyetjeje. Mendoj që takimi paraprak me ekzekutivin do tëna sqarojë dhe do të na heqë cdo pikëpyetje që ne kemi dhe ne ta kemi kohën sa më të frutshme për të bërë punën e duhur në këshill.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 35

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Pika 3 e rendit të ditës.

PËR NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Ashtu sikundër u veprua për përcaktimin e emrave që do të jenë në komisionet e përhershme, tani secili sipas grupeve do të para emrat sipas komisioneve përkatëse. Është vepruar sipas ligjit dhe neneve të përcaktimit të komisioneve të këshillit bashkiak. Secili nga grupet të fillojë me prezantimin e emrave.

Këshilltar P.Tollkuçi: Kemi rënë dakord me grupin tjetër që numri i komisioneve ekzistues të jetë i njëjti dhe në lidhje me dy komisione të cilët janë Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë dhe Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimi i të drejtave të njeriut dhe Strehimit të jetë me 7 anëtarë nga 5 që do jenë të tjerët, gjithashtu dhe Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimi i Ujërave Mbrojtjes së Mjedisit dhe Mbrojtjes së Diversitetit do të jetë me 7 anëtarë. Pjesa tjetër e komisioneve do të jetë me nga 5 anëtarë . Tani jemi gati të bëjmë propozimet, secili grup emrat e vet dhe pastaj të përcaktojmë emrat e kryetarëve dhe të nënkryetarëve për komisionet përkatëse .

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Në rast se kemi ndryshime në marrëveshjen e kryetarëve mes dy grupeve është mirë të votohet për ndryshimet, për komisionet një për një. Atëhere ju propozuat

qëKomisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë dhe Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimi i të drejtave të njeriut dhe Strehimit të jetë me 7 anëtarë

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimi i Ujërave Mbrojtjes së Mjedisit dhe Mbrojtjes sëBiodiversitetit me 7 anëtarë.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Këshilltar P.Tollkuçi:Është Komisioni i Titujve të Nderit. Në emër të partisë Socialiste unë propozoj 3 emra: Pandi Bello, Erjon Nexhipi, Paola Kodra.

Këshilltar D.Osmani: Nga grupi jonë propozojmë Elvin Bregu, Irvin Bode, Ismeralda Seidolli.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Kalojmë një nga një në votim sepse votimi është i hapur.

Hidhet në votim **Komisioni i Titujve të Nderit** dhe miratohet.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Këshilltar P.Tollkuçi: Vazhdojmë me Komisionin e Rregullores, Cështjeve Ligjore dhe Administrative, Pasurive tëBashkisë. Emrat që ne propozojmë: Erjon Nexhipi, Edlira Mitre, Skënder Dinellari.

Sekretare E.Naçi: Po Skënderi është nga parti tjetër apo jo?

Këshilltar P.Tollkuçi: Ne ramë dakord që këto komisione , në këtë komision lamë propozimin kryetari i Komisionit të Rregullores, Cështjeve Ligjore dhe Administrative, Pasurive të Paluajtshme do të ishte opozita. Ne kemi rënë dakord

Këshilltar D.Osmani: Rregullorja thotë që ju duhet të keni shumicën nëçdo komision apo jo?

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Përderisa është 1/3 nënkuptohet.

Këshilltar P.Tollkuçi: Ne mundet të shikojmë funksionimin e këshillit se si ka funksionuar në vitet e kaluara, që të mos marrim vendime të nxituara në këtë pjesë.

Sekretare E.Naçi: Neni 33 i rregullores Përbërja e Komisioneve të Përhershme, për aq sa është e mundur, pasqyron Grupet Politike të Këshilltarëve, sipas përpjesëtimit që zënë në Këshill. Propozimet për Kryetarët dhe anëtarëte Komisioneve të Përhershëm bëhen nga Grupet Politike të Këshilltarëve dhe miratohen nga Këshilli.

Këshilltar D.Osmani: Pika 5 e saj thotë: Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të dytë, pas krijimit të grupeve të këshilltarëve, përcakton pozitën (referuar shumicës) dhe opozitën (referuar pakicës) politike brenda Këshillit Bashkiak. Në bazë të kësaj ndarjeje dhe mbi bazën e propozimeve të Grupeve Politike të Këshilltarëve, zgjidhen anëtarët e Komisioneve të Përhershëm, bazuar në balancat politike dhe gjinore. Me vendim të Këshillit, pakicës politike i lihet kryesimi i 1/3 së Komisioneve të Përhershëm. Aty ku Kryetari i Komisionit është i shumicës, Zevëndëskryetari i Komisionit është i pakicës dhe anasjelltas.

Këshilltar E.Nexhipi: Në rast se shumica e plotëson me numra, patjetër, ndërsa kryesimi i lirëatë gjë e diskutuam, bëme një konsensus, madje dhe një kërkesë që kishit u plotësua.

Këshilltar D.Osmani: Jo nuk u plotësua sepse ju vendosët diçka sipas asaj që ju interesonte ju, dhe ju keni marrë të gjithë drejtimin e komisionit që ka të bëjë me financat

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Po është me ligj ajo.

Këshilltar D.Osmani: Nuk është me ligj ajo.

Këshilltare A.Përmeti: E para do doja që sipas rregullores atij që i jepet fjala ti jepet nga ai që drejton mbledhjen, sepse nëse fillojmë dhe bëjmë replika atëhere do të fillojmë të krijojmë një debat të panevojshëm, dhe tjetra është që nga ajo që kam kuptuar unë dhe nga ajo që na është vënë në dispozicion është rregullorja e qartë është që 1/3 i lihet pakicës që do të thotë 14 po ta pjestojmë për 3 është 4,6 dhe janë lënë 5 komisione në kryesi ndërsa anëtarësia është në bazë të votave osë të vëndeve që ne kemi në këshill sipas partive apo grupimeve politike dhe grupimi është i hapur. Këto janë 3 pika të qarta që ju si këshilltarë i keni lexuar dhe për pjesën tjetër është ajo që u tha. Të paktën të respektojmë këtë pjesën e marrjes lejë dhe dhënies lejë në pjesën e kësaj.

Këshilltar i opozitës: Vërtet që partia socialiste ka shumicën në këshill dhe do ketë shumicën edhe në komision por përse i përket përpjestimit nuk besoj se partia socialiste ka 3/5 e këshilltarëve që të ketë 3/5 e komisionerëve nëçdo komision. Duke pasur shumicën do të ketë shumicën në shumicën e komisioneve. Por besoj që në 1/3 e komisioneve mund ta ketë shumicën dhe opozita.

Këshilltar P.Tollkuci: Nëse do të ketë nevojë për pushim për ta diskutuar këtë pjesë jam dakord, por përsëri unë shpreh mendimin tim për atë bisedë që bëme dhe asaj i qëndroj, që ramë dakord që këto komisione do të drejtohen nga opozita por nuk do të thotë që opozita të ketë shumicën. Zgjedhjet prandaj bëhen që kush duhet të jetë shumicë dhe kush pakicë.

Këshilltar A.Habip : Neni 33 e shpreh qartë që një anëtar i komisionit nuk mund të jetë në më shumë se 3 komisione nëse mazhoranca përbërjen e anëtarëve e ka në bazë të kësaj rregulloreje atëhere nuk ka pse të vihet në dyshim shumica e komisioneve. Opozita ka të drejtën që të jetë në kryesim të 1/3 të komisioneve .

Këshilltar E. Bregu: Tani ne këtë po diskutojmë 1/3 sepse është në rregull, tani ideja është që ne siç gjetëm këtë kompromis për ndarjen e këtyre komisioneve apo dhe për numrin e tyre, prandaj mendojmë që atje ku kemi kryetarin të paktën në ato 5 të na lihej dhe kryesimi

Këshilltar E.Nexhipi: Nuk mund tja leme llogjikës as nuk mund tja lemë vullnetit tonë personal. Ka një rregullore që është e shprehur qartë, ka një vullnet politik i zgjedhësve i shprehur shumë qartë pa diferenca. Vullneti politik është shprehur qartë. Vullneti nga ana e grupit të partisë socialiste për ndarjen sipas rregullores u shpreh qartë. Të lutem nëse opozita ka nevojë për të diskutuar emrat meqë është keqkuptuar në këtë situatë bëjmë pushim në të kundërt vazhdojmë me procedurën.

Sekretare E.Naçi: Nuk e di çfarë është e paqartë por pika 4 thotë:Përbërja e Komisioneve të Përhershme, për aq sa është e mundur, pasqyron Grupet Politike të Këshilltarëve, sipas përpjesëtimit që zënë në Këshill.

Këshilltar P.Tollkuçi: Atëherë ne propozojmë në këtë komision: Erjon Nexhipi, Erjon Kurti dhe Edlira Mitre.

Këshilltar D.Osmani: Ne propozojmë Kristi Kocibelli, Ismeralda Seidolli.

Këshilltar P.Tollkuci: Duhet të propozojmë edhe kryetarin. Kryetarin e zgjedh komisioni vetë sipas asaj që kemi rënë dakord bashkë

Hidhet në votim përbërja e komisionit.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Komisioni tjetër i Apelit, Etikës, Standarteve dhe Konflikteve të Interesit.

Këshilltar P.Tollkuçi: Propozimet tona janë : Gurije Dedolli, Julian Mema, Ornela Alikaj.

Këshilltar D.Osmani: Klajdi Pllaha, Kristi Kocibelli.

Hidhet në votim përbërja e komisionit.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe Planifikimi i Zhvillimit të Strategjive të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.

Këshilltar P.Tollkuçi: Altin Habip, Ada Përmeti, Petrika Tollkuci.

Këshilltar D.Osmani: Devis Osmani, Alketa Zheku.

Hidhet në votim përbërja e komisionit.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjediseve, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve.

Këshilltar P.Tollkuci: Ne propozojmë: Erjon Kurti, Kostika Zguri, Valmira Nano.

Këshilltar D.Osmani: Suela Dinellari, Thoma Marku

Hidhet në votim përbërja e komisionit.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Turizmit dhe Zhvillimit Rural.

Këshilltar P.Tollkuci: Ada Përmeti, Johan Deli, Alma Burda.

Këshilltar D.Osmani: Elvin Bregu, Lazjon Petri.

Hidhet në votim përbërja e komisionit.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Komisioni i Zhvillimit Hapsinor dhe i Infrastrukturës

Këshilltar P.Tollkuçi: Erjon Nexhipi, Altin Habip, Majlinda Duni.

Këshilltar D.Osmani: Irvin Bode, Laureta Alidinaj

Hidhet në votim përbërja e komisionit.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit

Këshilltar P.Tollkuçi: Lambert Malaveci, Marsela Ciro Marin, Emiljano Muharrem

Këshilltar D.Osmeni: Fidel Kreka, Dorina Qyteza

Hidhet në votim përbërja e komisionit.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit të drejtave të njeriut, dhe Strehimit.

Këshilltar P.Tollkuçi: Anxhela Taho, Edlira Mitre, Ornela Alikaj, Erjon Kurti

Këshilltar D.Osmeni: Jorida Romacka, Lorenc Nako, Laureta Alidinaj

Hidhet në votim përbërja e komisionit.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Komisioni i Shëndetësisë, Veterenarisë, Mjedisit dhe Ndotjes së Konsumatorit

Këshilltar P.Tollkuçi: Majlinda Like, Julian Mema, Petrika Tollkuci

Këshilltar D.Osmeni: Jorida Romacka, Erald Fejzulla

Hidhet në votim përbërja e komisionit.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujrave, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Biodiversitetit

Këshilltar P.Tollkuçi: Emiljano Muharrem, Guriye Dedolli, Majlinda Duni, Kostika Zguri

Këshilltar D.Osmeni: Ismeralda Seidolli, Lorenc Nako, Lazjon Petri

Hidhet në votim përbërja e komisionit.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Clodhjes.

Këshilltar P.Tollkuçi: Lambert Malaveci, Erjols Haxhillari, Anxhela Taho

Këshilltar D.Osmani: Klajdi Pllaha, Alketa Zheku

Hidhet në votim përbërja e komisionit.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturore dhe Emërtimeve.

Këshilltar P.Tollkuçi: Paola Kodra, Pandi Bello, Erjols Haxhillari

Këshilltar D.Osmani: Suela Dinellari, Lazjon Petri

Hidhet në votim përbërja e komisionit.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Komisioni i Qeverisë Elektronike dhe Teknologjisë së Informacionit.

Këshilltar P.Tollkuçi: Johan Deli, Ornela Alikaj, Altin Habip.

Këshilltar D.Osmani: Lorenc Nako, Dorina Qyteza

Hidhet në votim përbërja e komisionit.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Komisioni për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Integrimi European.

Këshilltar P.Tollkuçi: Ada Përmeti, Johan Deli, Alma Burda.

Këshilltar D.Osmani: Devis Osman, Elvin Bregu.

Hidhet në votim përbërja e komisionit.

Vota PRO 36

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretare E.Naçi: Kemi këshilltarë të papërfaqësuar në komisione. Duhet të jenë të gjithë këshilltarët të përfaqësuar në komisione. Rregullorja kështu e thotë.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Mund të bëhet një seancë tjetër me qëllim që ata të pyeten njëherë.

Këshilltar P.Tollkuçi: Nuk mund të marrim vendime në emër të të tjerëve dhe nuk e dimë se ku ata e ndejnë veten më mirë në cilin komision. Unë besoj që herën tjetër mund të bëjmë një në 2 komisione të rritim numrin e tyre.

Sekretare E.Naçi: Për të saktësuar pak edhe këtë pjesën se si pozicionoheni ju lutem herës tjetër e dua me shkrim nga grupet përbërjen politike të grupeve dhe si përfaqësojnë këshilltarët.

Këshilltar E.Bregu: Sa anëtarë duhet të ketë.

Sekretare E.Naçi: Minimalisht 3 anëtarë.

Këshilltar L.Petri: Në rast se nuk je grupim politik çfarë ndodh?

Sekretare E.Naçi: Mund edhe të mos pozicionohesh po për ta ditur se po flasim në emër të grupit dhe unë duhet ta kem këtë gjë me shkrim.

Këshilltar L.Petri: Se unë personalisht përfaqësoj shoqërinë civile dhe mund të mos bashkohem me x parti.

Sekretare E.Naçi: Mund të mos bashkohesh me asnjë, je vet është e drejta jote.

Këshilltar E.Nexhipi: Ideja është këtu që grupi, kryetari i grupit është edhe pjesë e kryesisë prandaj edhe mund të të interesojë pjesa e qënies grup dhe kryetar grupi. Ndërsa çdo këshilltar është i lirë sdo të jetë pjesë e ndonjë grupi pavarisist se ti s'je i pavarur zgjedh të mos jesh pjesë e grupit, edhe unë nesë mund të mos jem pjesë e grupit, kjo është çështje vullneti personal. Grupi që të ekzistojë 3 minimmi.

Këshilltar D.Osmani: Ne jemi pjesë e opozitës, grupi do ketë një emër parti diçka apo është grup opozite.

Këshilltar E.Nexhipi: Duhet ta përcaktoni vetë.

Këshilltar D.Osmani: Ideja është që ne kemi në përbërjen tonë që nuk kanë parti, por qëndrojmë bashkë, mund të jemi brënda nuk është e thënë të kemi emërtim partiak ky grup apo duhet të ketë.

Sekretare E.Naçi: Deri në këto momente grupe të konsoliduara që sapo janë mandatuar nga zgjedhjet, kemi partinë socialiste dhe kualicionin bashkë fitojmë. Tani partitë e tjera të cilat përfaqësohen me 1 ose 2 mandate në këshill nëse nuk duan të bëjnë grup nuk ka asgjë, nëse ju flisni në emër të grupit dhe po propozoni dhe për parti të tjera unë dua të kem një dokument me shkrim ku të di grupet.

Këshilltar D.Osmani: Meqënëse unë propozova dhe Lazjonin apo Klajdin sot e do në këtë formë apo herën tjetër?

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: E rëndësishme është që janë përfshirë të gjithë këshilltarët. Edhe rregullorja e thotë që nëse ka lëvizje brënda komisioneve kjo është në dëshirën dhe vullnetin e këshilltarëve.

Këshilltar K.Pllaha: Më falni për procedurë sipas rregullores të KB thotë emërtimi i Komisionit numri i anëtarëve dhe përbërja e tij nuk mund të ndryshohen jo më herët se 1 vit nga miratim kështu që në rastin, kështu që në rastin në fjalë që mungojnë 2 këshilltarë dhe nuk mund të vendosim, mund ta vendosim sot dhe më pas të ndryshohet?

Sekretare E.Naçi: Po. Nëse e lexojmë rregulloren thuhet qëkjo rregullore mund të ndryshohet shtohet përmirësohet, pakësohet nëçdo moment që ju bini dakord. Baza e komisioneve janë 14 që janë caktuar në rregullore, po s'do të thotë që ju s'mund të shtoni një komision tjetër.

Këshilltar P.Tollkuçi: Unë mendoj që sikundër e thashë dhe pak më parë që ne nuk mund të marrim apo të vendosim emrin e një këshilltari i cili nuk është prezent. Ne nuk mund ti identifikojmë këta as si të njëjës forcë apo të njërit kualicon se nuk kanë fituar si pjesë e kualicionit, prandaj unë mendoj që herën tjetër kur këta persona të jenë të pranishëm dhe ata të shprehen në lidhje se ku ata e ndejnë veten e tyre, ne mendoj se të gjithë e kemi mundësinë dhe dëshirën që të bëjmë një ndryshim në numrin e x komisioni dhe besoj që kjo është në të mirën e punës që të mos kemi problematika në mbledhjet e ardhshme të këshillit.

Këshilltar L.Petri: Unë bie dakord me mendimin e parafolsit thjesht do të sugjeroja sepse rasti sot duhet të kthehet në mësim sepse sot është ky mandat nesër do të jetë një mandat tjetër në këshill, çfarë do të ndodhë nëse nuk do të vijnë 7,8 apo 18 anëtarë në një mbledhje. Mendoj që sekretariati duhet të konsultohet me një jurist për ta kopsitur këtë ngërc.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Vetë sekretarja është juriste dhe ajo ka vite që po merret me këtë punë. Megjithatë qëndrojmë atje ku tha Petrika.

Këshilltare A.Përmeti: Jam dakord me Petrikën sepse një person që nuk është prezent por mund tja kishim marrë më përpara kjo gjë mund të parashikohej nuk kemi pse të ndryshojmë rregulloren sepse duhet të jenë diskutuar më përpara se të mblidhen sipas grupeve. Ne nuk kemi pse ndryshojmë rregulloren duhet tja u kishim marrë këtyre personave dakordësinë më përpara. Jam dakord me Petrikën pa ndryshuar rregulloren.

Sekretare E.Naçi: Jo absolutisht.

Këshilltar I.Bode: Në lidhje me këtë çështje mendoj që rregullorja në nenin 33 e përcakton në pikën e 1) Emërtimi, numri, struktura dhe përbërja e Komisioneve të Përhershme propozohen nga Kryetari i Këshillit pas konsultimit me Kryetarët e Grupeve Politike të Këshilltarëve dhe miratohen me votim të hapur me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit

Këshilltar D.Osmani: Meqënëse ne me këtë pikë u dakordësuam deri tani mirësisht që ti lexojmë edhe këto ku ne kemi përfaqësimin me 1/3 komisionet për kryetarët qëti vemë në dijeni, pjesën tjetër e ka Petrik. Ne i ndamë

Këshilltar P.Tollkuci: I themi kështu me emër pastaj kur të mblidhet komisioni.

Këshilltar D.Osmani:Komisionin e Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative, Pasurive të Paluajtshme ne do të propozojmë Kristi Kocibellin kryetar.

Komisioni tjetër i Apelimit, Etikës, Standarteve dhe Konfliktive të Interesit z.Klajdi Pllaha kryetar.

Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë, Mjedisve, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve znj.Suela Dinellari

Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimi znj.Dorina Qyteza.

Komisioni për Marrëdhënien me Jashtë dhe Integrimin European z.Devis Osmani.

Këshilltar P.Tollkuci: Mbledhja e ardhshme e komisioneve kur bëhet dmth. Komisionet mblidhen më vete apo me mbledhjen e këshillit?

Sekretare E.Naci: Mblidhen kur të dëshironi.

Pika Të Ndryshme

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre:Kemi diçka në pika të ndryshme ?

Këshilltare L.Alidinaj: Në këto 2 pikat që do vazhdojnë kam dhe një pikë tjetër me një rast urgjent mund të them. Kam një rast në lagjen 6 ku dy persona të një familje njëri është i moshuar por i paaftë për të mbajtur familjen dhe i biri është në gjëndjen mendore i paaftë, janë persona që janë në gjëndje ekonomike shumë të vështirë, janë pa drita pa ujë për ata unë mendoj që do na plasë ndonjë pandemi është një papastërti shumë e madhe, nuk e di kush institucion merret nga bashkia që të merren, është rasti që ka rënë zjarri para disa kohësh në këtë familje me dy persona. Mendoj që duhet të merret në konsiderate, po të jetë mundësia të trajtohet edhe me fondin e vecantë që ne diskutuam.

Sekretare E.Naçi: Nëse ka të bëjë me rastin ne kemi kaluar një nga fondi i emergjencave nuk e di nëse është rasti konkret por jemi në proces gjyqësor pasi prefektura e ktheu nëse bëhet gjithmonë fjalë për këtë rast duhet ta verifikoj.

Këshilltar E.Nexhipi: Është situatë paaftësie.

Këshilltare L.Alidinaj: Është rast paaftësie, të dy personave për të mbajtur atë shpi.Ajo shpi është skandal në gjëndje shumë të vështirë dhe të paaftë për ta menaxhuar atë shtëpi.

Këshilltar E.Nexhipi: Në fund të mbledhjes ne mbledhemi me drejtoreshën Marjana Jorgji dhe i japim emrin si rast.

Këshilltare L.Alidinaj : Si mund ta zgjidhim.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Ka ndonjë gjë tjetër?

Këshilltar E.Bregu: Në lidhje me çështjen e universitetit dhe dokumentacionit të kadastrës mendoj që ti kërkojmë informacion institucioneve në lidhje me situatën nëse kadastra do të dërgojë informacion në qendrën në Tiranë dhe nuk do të jetë më në Korçë. Gjithashtu dhe një informacion në lidhje me universitetin me qëllim që opinioni publik të jetë i informuar. Dhe pika tjetër është që PD i ka kërkuar ambiente i ka kërkuar bashkisë sipas ligjit ambiente që tja vendosë në dispozicion prej 6 vjetesh dhe para 1 jave kemi drejtuar një shkresë dhe në 6 vjet rresht përgjigjia është marrë që vërtet ligji na detyron por nuk kemi pasur mundësi. Kështu që ne nuk mund të presim më shumë se 6 vjet që të krijohet mundësia është duke u shkelur ligji në lidhje me këtë pikë dhe bashkia duhet të marrë masa që të jetë korrekt me ligjin.

Këshilltar P.Tollkuci: Ne si KB mendoj që duhet ti përmbahemi kornizave ligjore sepse këtu na shikojnë dhe na dëgjojnë të gjithë, ne nuk mund të kërkojmë gjëra që nuk i dimë apo që nuk duhet ti kërkojmë ose mbase mund të kërkojmë dhe më shumë kështu që realisht ne duhet të vijmë të përgatitur ose të pyesim përpara se të shtrojmë disa pyetje apo disa komente në lidhje me problematika të caktuara. Për këto dy raste që u përmendën duhet të gjejmë një përgjigje por mbase duhet të dijim ku të drejtohem fillimisht dhe pastaj ta shtrojmë tek mbledhja e këshillit. Në lidhje me pjesën e fundit që u diskutua mendoj se i takon ekzekutivit dhe ne nuk jemi vendimmarrës të KB në lidhje me këtë pjesë. Nëse kemi diçka me ekzekutivin ne si KB duhet ta përgatisim që ata njerëz të na japin përgjigje dhe të kenë dijeni në lidhje me problematikën. Se kështu konsumohemi kot me njëri-tjetrin.

Këshilltar K.Pllaha: E aprovoj fjalën e z.Petrika dhe me dëshirën për të futur në rendin e ditës të mbledhjes së ardhshme një diskutim për çështjen e universitetit . Ne nuk e kemi të drejtën që të vendosim ose që të gjejmë dhe besoj që vetë universiteti ka kapacitetin që ti japë zgjidhjen e duhur. Ajo që do ishte në interes për opinionin publik është sesi ekzekutivi i bashkisë është pozicionuar në ndihmë të universitetit gjatë këtyre viteve dhe cilat janë planet apo projektet që bashkia ofron në mbështetje të universitetit, studentëve dhe pedagogëve dhe për këtë kërkoj që në mbledhjen e ardhshme të kemi një relacion nga kryetari i bashkisë apo përfaqësues të tjerë për këto pika brenda kuadrit ligjor. Kërkoj që të na shpaloset projekti dhe plani i bashkisë në lidhje me këtë në mënyrë që ne si këshilltarë të mësojmë të japim propozime apo ide të tjera mbi këtë çështje.

Këshilltar E.Nexhipi: Patjetër ne si KB duhet të japim qëndrimet tona edhe për institucione që operojnë në territorin e bashkisë kanë një impakt në zhvillimin apo në shërbimet ndaj qytetarit, nuk na kufizon askush që ne të japim opinion qëndrime. Nuk na i heq askush këtë kufizim. Informacioni i kërkuar nga z.Klajdi patjetër që është i vlefshëm, në një të ardhme mund të shprehim edhe opinionin tonë, sugjerimi im ishte për të mos u përfshirë në këtë ambient sepse edhe ne që punojmë atje nuk jemi të qartë akoma. Patjetër që ne kemi ofruar mjediset tona të bashkisë, kemi mbështetur aktivitete të universitetit, kemi mbështetur nga praktikat mësimore, kemi partneritet në disa fusha , pra nuk është që bashkia nuk ka mbështetje për universitetin. Dhe nuk mund të ecim nga llogjika që universiteti është institucion autonom dhe ne s'kemi të drejtë të flasim, sepse kur vjen puna për mbështetje për ndërtesa për paga i kërkojmë llogari politikës, dhe

kur vjen puna që kërkojmë llogari i themi politikës rri jashtë. Pra në këtë kontekst unë kufizova dhe ju bëra thirrje që ti largoheshim diskutimit për universitetin, të sqarohet situata, të mos krijojmë akoma më shumë tymnajë.

Këshilltar K.Pllaha: Jam plotësisht dakord, thjesht për të parë projektet që bashkia ka në mbështetje pa gjykuar vendimarrjen që univeriteti merr në vetvete për vazhdimësinë e tij. Ka thjesht lidhje me atë që i takon bashkisë, nuk po gjykoj çfarë vendime merr senati. Është thjesht një marrje informacion. Një kërkesë për mbledhjen e ardhshme.

Këshilltare E.Seidolli: Edhe unë në fakt në kuadër të këtyre që tha Klajdi jam në mbështetje të kësaj kërkesë, që unë mendoj se është bazike, ajo ç'ka ne na intereson është një relacion me marrëveshje ku universiteti ka me bashkinë Korçë në kuadër të projekteve që kanë zhvilluar sëbashku që dhe ne të jemi në dijeni të vijueshmërisë të këtyre projekteve apo marrëveshjeve.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Po patjetër, ju keni të drejtën të bëni një kërkesë me shkrim tja drejtoni sekretares së këshillit për projektet dhe vizionin e bashkisë në mbështetje të universitetit dhe patjetër ekzekutivi ka detyrimin ligjor që të përgjigjet për të gjithë.

Këshilltar K.Pllaha: Besoj se do ishte më mirë ta paraqiste këtë relacion brenda këshillit.

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Po në këshill.

Këshilltar E.Bregu: Në lidhje me çështjen që ngrita për dhënien e zyrave në mbledhjen tjetër të na paraqitet një relacion se çfarë duhet të bëjmë më tej

Zv/Kryetari i Këshillit E.Mitre: Unë mendoj që nëçdo mbledhje të këshillit është patjetër është përfaqësuesi ligjor i bashkisë që sqaron për çdo gjë. Ne në këtë moment nuk mund të flasim dot .

Këshilltare L.Alidinaj: Lidhur me një sensibilizim se tani po diskutojmë jo të marrim të mos marrim, por ne do të themi ato që janë shqetësime të qytetit se prandaj kemi ardhur këtu, kemi ardhur me votat e qytetarëve.

Sekretare E.Naçi: Nëçdo mbledhje është përfaqësues nga ekzekutivi kështu që do jetë mirë që të gjitha këto që po themi tani të jetë dhe përfaqësuesi që secili dhe ju të marrë përgjigje.

Këshilltar E.Bregu: Sot pse nuk ka përfaqësues?

Sekretare E.Naçi: Sepse këtë mbledhje e kemi thirrur vetë për të ngritur komisionet, e vetmja çështje që nuk priste ishte ndihma ekonomike, ishte përfaqësuesi, sepse tjetra ishte puna jonë.

Këshilltar E.Nexhipi: Është shumë e drejtë mund të ishte edhe sot në fakt, por si rregull ne e kemi pasur mbledhjen të enjten e fundit tëçdo muaj.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

KRYETARI
ANA VERUSHI